



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 578 Prot.

Tiranë, më datë 18.04.2023

VENDIM

Nr. 184, datë 18.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “*Punime mirëmbajtje*”, Brenda Kufirit Qendër Historike, Qeparo, me aplikues dhe zhvillues Kristo Dede;
 - Të paraqitet genplani i objektit duke pasqyruar pozicionin e këtij objekti në lidhje me qendrën historike;
 - Projekti grafik i paraqitur duhet të pasqyrojë patologjitë e objektit dhe nderhyrjet në të në mënyrë që të ketë një përputhje të zërave që do restaurohen (paraqitur në preventiv) me grafikën e projektit dhe anën fotografike të tij;
 - Në certifikatën e pronësisë rezulton ndërtim 46 m² ndërsa realisht në projekt sipërfaqe ndërtimi është më madhe (në dokumentin në format .dwg nuk paraqiten planimetritë);
 - Prokura e dhënë nga katër bashkëpronarët që rezultojnë të vitit 2012 dhe 2017, nuk përfshin autorizimin për aplikim në programin e bonusit të rijetësimit.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

